



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org Unit Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	Nr. Prof. Br. Prof. Prof.No: Dnta: Datum: Date: PRISHTINË/A NO.1
01/3 1	4406 25.11.25

Raporti tre mujor, Korrik-Shtator 2025 TM3

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e nëntë (9) të rregullt të mbajtur me datë 24.11.2025 pas shqyrtimit të Raportit TM3-2025 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv:	Kryesuesi i BD:
Nënshkrimi	Faruk MUJKA	Bajram MUSTAFA
Data: 24.11.2025		



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bill Clinton" Nr.13 - Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Për : Bordin e Drejtorëve

Nga: Faruk Mujka - Kryeshef Ekzekutiv – N.H "Ibër-Lepenc" Sh.A

Lënda: Raport tremujor i punës: Korrik-Gusht -Shtator 2025

Data: 23.10.2025

Efikasiteti i përgjithshëm tremujor Korrik-Gusht-Shtator 2025



Gjatë tremujorit të tretë për vitin 2025(TM3) kemi pas mjaft angazhime dhe sfida që i kemi përfunduar me përkushtim, duke arritur suksese të dukshme . Por kjo nuk do të thotë që ne duhet të ngadalësojmë hapin në rrugëtimin tonë . Prandaj këtë vit do të vazhdojmë punën me një përkushtim edhe më të madh, drejt realizimit të qëllimeve bazuar në Planin e biznesit për këtë vit .

Nga zyra e shitjes kam pranuar këtë pasqyrë të punës , paraqitur në tabelat si në vijim :

TM3 Shitja e Energjisë Elektrike	
Muaji	Vlera €
Korrik	€ 698,059.97
Gusht	€ 495,671.14
Shtator	€ 395,285.64
Total	€ 1,589,016.75



Aktivitetet e Departamenteve

Departamenti „Uji dhe Gjenerimi”

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 (Korrik-Shtator), Departamenti "Uji dhe Gjenerimi" ka realizuar aktivitete të rëndësishme për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe distribuimit të ujit për të gjithë konsumatorët, me theks të veçantë edhe përkundër vështirësive si pasojë e punimeve nga projekti WSCPP. Janë distribuuar gjithsej 20,759,075 m³ ujë tek konsumatorët kryesor, ndërsa nga HC Ujëmani janë gjeneruar 10,687.64 MWh energji elektrike, që paraqet 40% më pak se Plani i biznesit prej 18,000 MWh për këtë periudhë. Niveli i akumulimit Ujëman ka pësuar rënie të vazhdueshme, duke filluar nga 686.35m (311 mil. m³) në fillim të Korrikut dhe duke rënë në 683.17m (282 mil. m³) në fund të Shtatorit, si rezultat i prurjeve të ulëta dhe nevojave intensive për ujitje.

AKTIVITETET KRYESORE

1.1 Mirëmbajtja e Infrastrukturës

- **Kanali kryesor:** janë kryer punët e rregullta të mirëmbajtjes për sigurimin e rrjedhës optimale të ujit dhe furnizimin cilësor të konsumatorëve gjatë sezonit intensiv të ujitjes;
- **Kanalet sekondare:** është vazhduar pastrimi sistematik dhe mirëmbajtja për garantimin e shpërndarjes efektive të ujit për konsumatorët gjatë periudhës verore;
- **Diga e Ujmanit:** është vazhduar pastrimi i vegjetacionit dhe materialeve inerte përgjatë zonës së digës;
- **Sistemi i ujitjes:**
 - Në SP Besi janë realizuar 863 orë pune dhe janë shtyrë 3,417,480 m³ ujë në sistem
 - Në SP Bivolak janë realizuar 316 orë pune dhe janë shtyrë 1,478,880 m³ ujë në sistem
- **Koordinimi operacional:** është siguruar menaxhimi i vazhdueshëm i resurseve ujore në kushte të prurjeve të ulëta, duke koordinuar nevojat e gjenerimit të energjisë me kërkesat për ujitje.

1.2 Menaxhimi i resurseve ujore


- Optimizimi i shpërndarjes së ujit në kanalin kryesor për plotësimin e nevojave të ujitjes gjatë sezonit veror në kushte të resurseve të kufizuara ujore;
- Koordinimi i ngushtë i aktiviteteve me Departamentin e Ujitjes për menaxhimin efikas të sasive të disponueshme dhe prioritizimin e konsumatorëve kryesor.

2. DISTRIBUIMI I UJIT

Gjatë tremujorit Korrik-Shtator 2025 janë distribtuar gjithsej **20,759,075m³** ujë tek konsumatorët kryesorë sipas këtij shpërndarjeje:


TM3	m ³
KRU Mitrovicë	5,502,351
KRU Mitrovicë (Vushtrri)	2,148,961
KUR Prishtina(Shkabaj)	4,242,500
KUR Prishtina(Drenas)	997,193
NewCo Ferronikël CoL.L.C	378,306
KOSOVA A	5,379,660
KOSOVA B	2,110,104
TOTALI	20,759,075

Paraqitja grafike e sasive të distribtuar të ujit në m³ Korrik-Shtator 2025



	2021	2022	2023	2024	2025
KRU Mitrovicë	5,769,254	5,347,981	5,763,118	5,533,152	5,502,351
KRU Mitrovicë (Vushtrri)	1,956,541	1,970,875	2,141,294	2,181,026	2,148,961
KUR Prishtina(Shkabaj)	4,521,096	4,269,114	4,108,624	4,318,500	4,242,500
KUR Prishtina(Drenas)	1,038,056	1,038,381	897,023	1,025,127	997,193
NewCo Ferronikel CoL.L.C	575,294	400,010	645,977	494,667	378,306
KOSOVA A	2,318,760	2,782,080	2,782,080	2,782,080	2,110,104
KOSOVA B	925,931	1,386,180	254,520	2,464,920	5,379,660

Sasitë e distribuara të ujit për gjatë viteve 2021-2025 për TM3



3. GJENERIMI I ENERGJISË


Gjatë tremujorit Korrik-Shtator 2025, nga HC Ujëmani janë gjeneruar gjithsej **10,687.64 MWh** energji elektrike, prej të cilave **10,116.84 MWh** janë injektuar në sistemin transmetues, apo **40% më pak** se sa ishte planifikuar për këtë periudhë (18,000 MWh).

3.1 Shpërndarja e Gjenerimit Sipas Muajve:

- **Korrik:** 4,487.55 MWh (25% më pak se plani prej 6,000 MWh)
- **Gusht:** 3,625.68 MWh (40% më pak se plani prej 6,000 MWh)
- **Shtator:** 2,574.41 MWh (57% më pak se plani prej 6,000 MWh)


Krahasimi i gjenerimit me periudhën e njejtë për vitet 2016-2025

Krahasimi i gjenerimit nga HC ndër vitet 2016-2025




Niveli i ujit në akumulim me 1 Korrik ka qenë në kuotën 686.35 m (311 mil. m³, shkalla 48) ndërsa me 30 Shtator niveli ka qenë në kuotën 683.17 m (282 mil. m³, shkalla 66.5)

Niveli i akumulimit në pendën "Ujëmani" TM3 2025





Niveli i Akumulimit në pendën "Ujëmani" gjatë periudhës kohore TM3 ndër vitet 2016-2025




Prurjet mesatare në akumulimin Ujëman gjatë tremujorit TM3 ishin **2.9 m³/sec**

	Vëllimi 10 ⁶ m ³	Prurjet m ³ /sec
Korrik	311	3.29
Gusht	297	3.30
Shtator	289	2.20



	Prurjet gjatë viteve m ³ /sec									
	2025	2024	2023	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016
<i>Korrik</i>	3.29	4.01	11.5	3.9	6.05	7.3	9.3	22.5	6.4	6.7
<i>Gusht</i>	3.3	2.5	5.2	5.1	5.12	11.4	9.02	11.8	5.7	7.9
<i>Shtator</i>	2.2	2.9	8.4	8.8	4.07	7.2	4.9	5.4	3	13.5

Prurjet gjatë viteve për TM3 gjatë viteve 2016-2025



Departamenti "Ujitja"

Departamenti "Ujitja" ka vazhduar aktivitetet e saj gjatë muajve Korrik, Gusht, dhe Shtator, për të siguruar furnizimin e fermerëve me ujë për ujitjen e tokave bujqësore. Punëtorët në terren janë kujdesur që furnizimi i fermerëve me ujë të jetë në sasi dhe cilësi të duhur, ku kanë kryer inspektimin e sistemit të ujitjes për të garantuar mbrojtjen e tij nga veprimet e ndryshme të personave të papërgjegjshëm, përfshirë vjedhjet e pajisjeve fazonerike, dëmtimet e gypave tjera. Krejt kjo me qëllim që të sigurohet që sistemi i ujitjes të funksionoj pa probleme dhe furnizimi i fermerëve me ujë të jetë pa ndërprerje.

Muaji Korrik 2025:

Gjatë muajit Korrik në të tri Njësitë Punuese, punët kanë vazhduar në furnizimin e fermerëve me ujë, në cilësi dhe sasi të duhur, për ujitjen e kulturave bujqësore dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit të ujitjes. Për asye të mbretërimit të temperaturave të larta që nga fillimi i muajt Qershor, muaji Korrik 2025, ka filluar me një intenzitet shumë të lartë të ujitjes dhe me sfida të mëdha në evitimin e dëmeve të shkaktuara si rezultat i dëmtimit të gypave dhe pjesëve të tjera fazonerike. Gjatë muajit Korrik në të tri Njësitë Punuese, përpos operimit me sistemin e ujitjes, gjegjësisht furnizimit të fermerëve me ujë për ujitje, aktivitetet në terren janë përqendruar në evitimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara në hidrosistem, përfshi këtu edhe ndërhyrjet emergjente në mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes. Ekipet punuese të terrenit kanë qenë të angazhuara gjatë gjithë kohës për:

- Sanimin e dëmtimeve në rrjetin e gypave të ujitjes;
- Pastrimin dhe ndërrimin e hidrantëve të dëmtuar;
- Pastrimin e të gjitha grilave nëpër ujëmarrësa, në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i pandërprerë gjatë tërë sezonit të ujitjes.

-Një nga sfidat më të mëdha të muajit Korrik 2025, ishte dëmtimi i papritur i tubacioneve kryesore V dhe V'-prim të profilit Ø 700 mm dhe Ø 600 mm, që përbëjnë një segment jetik për furnizimin me ujë të Fushës së Mitrovicës, njëra ndër fushat më të madhe që menaxhohet nga Njësia Punuese në Vushtri. Pas marrjes së informatës për dëmtimin e gypave, janë mobilizuar të gjithë punëtorët e Nj.P. në Vushtri dhe brënda 24 orëve është bërë sanimi i dy gypave.

-Gjatë muajit Korrik kemi patur edhe një sfidë tjetër, ku si pasojë e shpërthimit të njëres prej pompave në S.P. Samadrexhë ka ndodhur përmytja e Stacionit Pompik dhe si pasojë janë dëmtuar elektromotorët e pompave. Masat e ndërmarra përfshinë: organizimin e punëtorve dhe largimi i ujit nga Salla e pompave brënda disa orësh, në bashkëpunim me Operatorin Ekonomik që ishte duke punuar, elektromotorët i kemi transportuar për në Podujevë ku është bërë tharja e tyre dhe riaftësimi i tyre për punë. I tërë sanimi në S.P Samadrexhë është kryer brënda një jave dhe në asnjërin nga rastet nuk kemi pasur vonesa në furnizimin e fermerëve me ujë. Vlen të theksohet se gjatë muajit Korrik kemi pasur edhe plasje të tjera të gypave në Nj.P. Shkabaj dhe Komoran, por me ndërhyrjen e shpejtë të ekipeve të terrenit, gypat janë ndërruar dhe nuk kemi pasur ndërprerje të theksuara në furnizimin e fermerëve me ujë. Nga kjo mund të konkludohet se sipërfaqet e kontraktuara për ujitje deri në fund të muajit Korrik 2025, janë rreth 1991.00 ha, me tendencë të ngritjes së lehtë gjatë muajt Gusht.

Muaji Gusht 2025:

Duhet theksuar se për arsye se një pjesë e kulturave bujqësore kanë përfunduar fazën vegetative dhe së ka filluar pjekja e tyre gjatë muajit Gusht 2025, intensiteti i ujitjes ka rënë dukshëm, por punët kanë vazhduar në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të ujitjes.

Aktivitetet e Departamentit "Ujitja" së bashku me tri Njësitë Punuese janë orjentuar në mirëmbajtjen e rregullt të sistemit si dhe në ndërhyrjet emergjente kur kemi pasur dëmtim të gypave apo pjesëve të tjera fazonerike në sistem. Janë bërë vizita të përditëshme të fermëve në terren janë lidhur kontrata dhe është bërë kontrollimi i vazhdueshëm i procesit të ujitjes. Gjatë muajit Gusht kemi pasur pëlqitje të gypave, por të profileve më të vogla si dhe bllokim të hidrantave, por falë ndërhyrjes së shpejtë të ekipeve të terrenit, gypat janë sanuar/ndërruar, hidrantat janë pastruar, dhe nuk kemi pasur ndërprerje të theksuara të ujitjes së kulturave bujqësore. Me një menaxhim dhe bashkëpunim të shkëlqyer kemi arritur që të realizojmë evitimin e të gjitha dëmeve, duke mos e ndërprerë për asnjë moment procesin e furnizimit me ujë të fermëve për ujitjen e tokave bujqësore. Gjatë muajit Gusht kemi organizuar takime me fermerët, në këto takime është diskutuar rreth problemeve që po e përcjellin ujitjen në përgjithësi, veçanërisht kemi diskutuar dhe kemi kërkuar nga fermerët që përdorimi i ujit të behët në mënyrë sa më racionale me qëllim që të mos dëmtohen kulturat bujqësore, dhe uji të shfrytëzohet sa më racionalisht. Në këto takime jemi munduar që fermerëve të ju shpjegojmë dëmtimet e kulturave bujqësore nga përdorimi i tepruar i ujit për ujitje. Gjatë muajit Gusht ka vazhduar kontraktimi i sipërfaqeve të ujitura është bërë evidentimi i sipërfaqeve të ujitura. Nga kjo që u tha më lartë del se sipërfaqet e kontraktuara për ujitje deri në fund të muajit Gusht janë rreth 2132.00 ha.

Muaji Shtator 2025:

Në muajin Shtator 2025, Departamenti "Ujitja" me të tri Njësitë Punuese ka vazhduar të kryejë aktivitetet e saj në përputhje me detyrat dhe rregulloren për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes. Punët kanë vazhduar në teren, me fokus në mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, në mënyrë që fermerët të furnizohen me ujë, me presion, cilësi dhe sasi të mjaftueshme për ujitjen e kulturave bujqësore. Përkundër kushteve meteorologjike, thatësisë që ka mbretëruar edhe gjatë muajit shtator, kërkesat për ujitjen e kulturave bujqësore në fushë të hapur kanë rënë në masë të madhe. Kjo për arsye se misri dhe patatet si dy kultura kryesore, të kultivuara nga fermerët, kanë mbaruar fazën e tyre vegetative dhe se ka filluar vjelja e tyre. Megjithatë, furnizimi me ujë për ujitjen e kulturave bujqësore edhe gjatë muajit Shtator ka vazhduar, sidomos për ujitjen e disa kulturave perimore siç janë: lakra, spaci, domatja dhe kulturat e kultivuara në ambiente të mbyllura, pra në sera. Në fillim të muajit Shtator, bazuar edhe në rregulloret e brendshme dhe me kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv, kemi filluar punët në përgatitjen e Planit të Biznesit për vitin 2026. Departamenti "Ujitja" me të tre Njësitë Punuese ka filluar punën në përgatitjen e Planit të Biznesit për vitin 2026. Gjatë tërë sezonit të ujitjes, pra Qershor-Shtator 2025, sistemi i ujitjes është mbajtur i mbushur me ujë dhe nën presion 2.5 deri 5 bar, në rreth **9813.00 ha**, por fermerët i kanë ujitur **2139.45 ha**. Duhet theksuar se më Planin e Biznesit për vitin 2025, për ujitje janë planifikuar 1900.00 ha, por janë ujitur 2139.4 ha, ose 12.6 % mbi planin. Në ngritjen e sipërfaqeve të ujitura kanë ndikuar shumë faktorë, besoj që ndër faktorët kryesor janë kushtet meteorologjike, pra thatësira që ka mbretëruar nga fillimi i muajit Qershor duke vazhduar deri në fund të sezonit të ujitjes, gjithashtu një ndikim në rritjen e sipërfaqeve të ujitura e ka edhe subvencionimi i ujitjes nga komunat: Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Mitrovicë, Drenas dhe N.H. "Iber-Lepenc".

Duhet theksuar edhe angazhimin e Departamentit "Ujitja" së bashku me tri Njësitë Punuese: Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran, ky angazhim ka bërë që për asnjë moment të mos ndërpritët furnizimi me ujë i fermëve. Pra operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes, gjatë tërë sezonit të ujitjes kanë qenë në nivelin e duhur. Më 30 Shtator sezoni i ujitjes zyrtarisht ka përfunduar dhe punëtor e terrenit kanë filluar zbrazjen e sistemit të ujitjes.

Më poshtë në mënyrë tabelare po paraqesim sipërfaqet e planifikuara për vitin 2025 dhe ato të kontraktuara deri më 30 Shtator 2025.

Tab.1.Paraqitja tabelare e siperfaqëve të instaluar, të rehabilituara, të ujitura gjatë viteve


2022- 2025, të planifikuara për vitin 2025 dhe të ujitura deri me 30 Shtator 2025

Nr .	Njësia Punuese	Sipërfaqë e instaluar ha.	Sipërfaqë e rehabilituar ha.	Sipërfaqë e ujitura ha. 2022	Sipërfaqë e ujitura ha. 2023	Sipërfaqë e ujitura ha. 2024	Sipërfaqë e planifikuar a ha. 2025	Sipërfaqë e ujitura ha. 2025
1	Vushtrri	7200.00	4500.00	734.28	655.30	824.39	850.00	967.98
2	Shkabaj	7100.00	2500.00	685.81	601.66	727.39	740.00	763.82
3	Komora n	5620.00	2813.00	459.63	111.37	200.84	310.00	407.65
TOTALI :		19920.00	9813.00	1879.72	1368.33	1752.62	1900.00	2139.45

Në vazhdim me foto po paraqesim disa nga aktivitetet e Departamentit „Ujitja” gjatë TM3- Qershor - Shtatorit 2025



Largimi igypave të dëmtuar Ø 700 dhe Ø 600 dhe vendosja e gypave të ri, në fushën e Mitrovicë



Dëmtimi i pompës në Samadrexhë dhe mbushja më ujë e sallës së pomopave.



Dëmtimi i gypit me profil Ø 600, Fushticë, dhe vendosja e gypit të ri.



Ujitja e patates dhe misrit



Ujitja e shalqinit

Ujitja e lakrës

Konkluzion- Bazuar ne Planin e Biznesit për vitin 2025, Departamenti "Ujitja" gjatë Tre Mujorit të Tretë - Korrik, Gusht dhe Shtator 2025, ka realizuar objektivat në:

- Mirëmbajtjen dhe Operimin e vazhdueshme të sistemit të ujitjes gjatë muajve: Korrik, Gusht dhe Shtator.
- Furnizim me ujë: në kohë, me sasi dhe me cilësi të duhur për ujitjen e tokave bujqësore, si dhe
- Tejkalimi i planit për rreth 12.6 %

Përfundime – N.H. "Ibër-Lepenc" në bashkëpunim me Departamentin "Ujitja", në Planin e Biznesit të vitit 2025, ka parapar që fermerët mund të ujin rreth 1900 ha, por si rezultat i temperaturave të larta dhe mungesës së rreshjeve që mbretëruan nga muaji Qershor deri në fund të Shtatori dhe Marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet NH "Iber-Lepenc" dhe komunave Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Mitrovicë dhe Drenas, fermerët e kanë shfrytëzuar ujin për ujitjen e kulturave bujqësore për **2139.45 ha**, në përqindje i bie se plani i ujitjes është tejkaluar për rreth 12.6 %. Angazhimi i Departamentit "Ujitja me tri Njësitë

Punuese gjatë sezonit të ujitjes 2025, ishte maksimale subvencionimi i ujitjes nga komunat: Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Mitrovicë, Drenas dhe N.H. "Ibër-Lepenc", duhet theksuar se: ujitja e tokave bujqësore varet nga fermerët, nga niveli i zhvillimit të tyre, tregu i brendshëm, i jashtëm i prodhimeve bujqësore dhe nga shumë faktor të tjerë që N.H., Ibër-Lepenc" nuk mund të ndikoj. Duhet theksuar se Departamenti "Ujitja" ka ofruar shërbime në këto komuna: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Drenas ku sistemi i ujitjes gjatë tremujorit të tretë TM3-2025, është mbajtur i mbushur me ujë në rreth 9813 ha, dhe nën presion 2.5 – 5 bar, fermerët bazuar në kushtet dhe rrethanat e lartcekura kanë ujitur **2139.45 ha**.

Shërbimi i Financave

Të hyrat

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 të hyrat e ndërmarrjes janë realizuar në vlerë **2,588,900.35€**, ndërsa ishin planifikuar të realizohen në vlerë prej **2,606,020 €** që do të thotë që të hyrat e realizuara janë për **1%** më të ulëta se të planifikuara ndërsa për **30%** më të ulëta se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

- Nga energjia elektrike janë realizuar të hyrat në vlerë prej **1,588,883 €**, ndërsa kanë qenë të planifikuara të realizohen të hyrat në vlerë **1,890,000 €** apo shprehur në përqindje realizimi ishte më i ulët për **16%** se planifikimi dhe për **45 %** më i ulët se realizimi në vitin paraprak.
- Nga shitja e ujit të papërpunuar janë realizuar të hyrat në vlerë prej **903,004.09 €**, ndërsa të planifikuara ishin **716,019.50 €**. Realizimi ishte për **26%** më i lartë se planifikimi dhe për **17 %** më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.
- Të hyrat tjera në vlerë **97,013.57 €** janë kryesisht të ardhura nga interesi bankar.
- Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të hyrat sipas llojit, sasisë dhe vlerës monetare:

Tabela nr. 1 RAPORTI I BIZNESIT PËR PERIUDHËN TM3 2025

Nr.	Emërtimi	Nj.mat.	Realizimi TM 3 2024	Plani TM 3 2025	Realizimi TM 3 2025	Indeksi plani	Indeksi 2023
0	1	2	3	4	5	6 (5:4)	7(5:3)
1	PRODHIMI						
1.1	Energjia elektrike	Mwh	13,929.07	18,000.00	10,626.29	59	76
1.2	Uji	m³	18,799,472.00	17,645,820	20,759,075	118	110
1.3	Ujitja	ha					
2	TË HYRAT		3,718,073	2,606,020	2,588,900	99	70
2.1	Energjia elektrike	€	2,907,747	1,890,000	1,588,883	84	55

2.2	Uji	"	769,535.73	716,019.50	903,004.09	126	117
2.3	Ujitja	"		-	-	0	0
2.4	Të tjera	"	40,790.29	-	97,013.57	0	238

Shpenzimet

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 shpenzimet e ndërmarrjes kanë arritur vlerën prej **1,703,838€**, ndërsa ishin planifikuar të shpenzohen **1,636,050€**. Realizimi i shpenzimeve është më i lartë për **4.14%** në krahasim me planin dhe për **25 %** më i lartë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Shpenzimet kryesore të ndërmarrjes gjatë këtij 3 mujori janë në paga dhe medijtje, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve janë kryesisht taksat e ndryshme për rregullatorë, shpenzimet komunale ku ato të energjisë elektrike janë dukshë mbi planin për shkak të daljes në tregun e hapur, pastaj shpenzimet e karburanteve dhe shpenzimet e mirëmbajtjes.

Në vijim janë paraqitur në formë analitike të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë periudhës korrik-shtator 2025:

Tabela nr. 2. Raporti analitik i shpenzimeve

Kodi	Kategoria e shpenzimeve	Realizimi TM 3 2024	Plani TM 3 2025	Realizimi TM3 2025	Indeksi %	Indeksi %
		1	2	3	4=(3:2)	5=(3:1)
B.1	Pagat dhe medijtjet	799,610.20	1,130,322.08	1,177,133.44	104	147
B.1.1	Pagat e rregullta	574,105.76	812,426.40	726,483.50	89	127
B.1.2	Paga Jashtë orarit	9,147.48	19,950.00	18,804.40	0	0
B.1.3	Pagat tjera (Bonuset-24 paga)	0.00	0.00	136,728.49	-	-
B.1.4	Paga përcjellëse	0.00	0.00	0.00	0	0
B.1.5	Shujta	66,052.00	77,262.00	74,888.00	97	113
B.1.6	Tatimi në paga	50,026.68	73,921.06	77,519.86	105	155
B.1.7	Kontributi i Ndërmarrjes	37,851.04	55,681.31	55,697.78	100	84
B.1.8	Kontributi punëtorit	37,851.04	55,681.31	55,697.78	100	147
B.1.9	Sindikata	2,402.58	0.00	3,282.49	0	9
B.1.10	Sigurimi shëndetësor	14,352.10	26,550.00	19,163.20	72	798
B.1.11	Pagat e bordit	7,821.52	8,850.00	8,867.94	100	62

B.2	Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare dhe reprezentacionet	1,911.94	7,940.00	3,250.76	41	170
B.2.1	Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	0.00	5,060.00	1,608.39	32	-
B.2.2	Shpenzimet e reprezentacionit	1,911.94	2,880.00	1,642.37	57	86
B.3	Shpenzimet e marketingut	0.00	900.00	0.00	0	0
B.3.2	Shpenzimet e marketingut	0.00	900.00	0.00	0	0
B.4	Shpenzimet e mirëmbajtjes	7,174.38	66,688.76	13,317.94	20	186
B.4.1	Mirëmb.automj.(serv. rregull, gomat, auto pjesë)	3,666.61	12,416.76	7,203.10	58	196
B.4.2	Mirëmb.e objekteve dhe paisjeve	70.00	30,010.00	711.56	2	1017
B.4.3	Mirëmbajtja infrastrukturore	0.00	9,750.00	0.00	0	0
B.4.4	Mirëmbajtja tekniko-informative	2,691.75	12,720.00	5,319.38	42	198
B.4.5	Servis.-mbushja AKZ(aparat kundër zjarrit)	746.02	1,792.00	83.90	5	11
B.5	Shpenzimet komunale	137,313.48	132,159.56	249,734.22	189	182
B.5.1	Shpenzimet e ujit	812.86	911.38	1,230.51	135	151
B.5.2	Shpenzimet për mbeturina	464.87	467.65	1,083.33	232	233
B.5.3	Energjia Elektrike	136,035.75	130,780.53	247,420.38	189	182
B.5.4	Shpenzimet e ngrohjes	0.00	0.00	0.00		
B.6	Material harxhues	25,710.15	6,870.00	10,213.60	149	40
B.6.1	Art.te vegjël (paisje pune)	5,259.67	750.00	8,852.48	1180	168
B.6.2	MHT-mbrojtja higjeno-teknike	20,191.58	0.00	1,018.26		5
B.6.3	Material elektrik	213.14	270.00	59.30	0	28
B.6.4	Material higjenik	45.76	1,860.00	283.56	15	620
B.6.5	Material për zyre	0.00	3,990.00	0.00	0	0
B.7	Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes	21,936.22	31,000.00	22,193.94	72	101
B.7.1	Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes	21,936.22	31,000.00	22,193.94	72	101
B.8	Shpenzimet për shërbime	320.00	33,790.00	20,806.85	62	6502
B.8.1	Trajnime	320.00	4,300.00	19,217.00	447	6005
B.8.2	Shpenzimet e shtypjes	0.00	150.00	233.92	156	-
B.8.3	Shpenzime projektuese	0.00	0.00	1,355.93	0	0
B.8.4	Rivlersimi	0.00	0.00	0.00		
B.8.5	Shpen.shërbimeve ligjore	0.00	29,340.00	0.00		
B.9	Shpenzime tjera	170,553.26	42,960.00	23,558.32	55	14
B.9.1	Shpenzime tjera	167,732.52	41,010.00	22,536.45	55	13
B.9.2	Parkingu për automjete	1,048.74	1,350.00	756.87	56	72
B.9.3	Autolarja	352.00	300.00	265.00	88	75

B.9.4	Çregjistrimet	0	0.00	0.00	#DIV/0!	
B.9.5	Konkurset	1,420.00	300.00	0.00	0	0
B.12	Shpenzimet telekomunikimit	6,020.14	7,423.50	6,406.95	86	106
B.12.1	Telefonia fikse	135.62	330.00	142.52	43	105
B.12.2	Telefonia mobile	1,572.07	1,927.50	1,831.65	95	117
B.12.3	Kablloviku	256.87	40.50	212.91	526	83
B.12.4	Interneti	4,033.05	5,065.50	4,197.91	83	104
B.12.5	Shpenzimet postare	22.53	60.00	21.96	37	97
B.13	Derivatet	15,195.98	19,731.82	15,292.33	78	101
B.13.1	Nafta	15,195.98	17,080.00	14,702.62	86	97
B.13.2	Benzina	0.00	110.00	0.00	0	0
B.13.3	Vajrat	-	2,541.82	589.71	23	-
B.14	Detyrime kontigjente	0.00	0.00	0.00		
B.14.1	Detyrime kontigjente	0.00	0.00	0.00		
B.15	Provizionet dhe taksat	178,902.17	149,964.30	156,773.74	105	88
B.15.1	Tatimi ne pronë	0.00	0.00	0.00	0	
B.15.2	Taksa për rregullatorë	52,640.66	62,189.66	67,314.73	108	0
B.15.2.1	Taksa për MMPH	123,496.07	82,746.64	84,405.81	102	68
B.15.3	Provizioni bankar	740.82	300.00	970.56	324	131
B.15.4	Sigurimi i automjeteve	1,147.94	2,928.00	1,777.03	61	155
B.15.5	Regjistrimi i automjeteve	876.68	1,800.00	2,305.61	79	263
B.15.6	Interesi i kredisë BB	0.00	0.00	0.00	0	0
B.15.7	Tatimi në fitim	0.00	0.00	0.00	0	0
B.16	Kompenzimi i dëmëve	0.00	6,300.00	5,156.00	82	0
B.16.1	Kompenzimi i dëmëve	0.00	6,300.00	5,156.00	82	0
B.17	Shpenzimet nga imbalanca	0.00	0.00	0.00	0	0
B.17.1	Shpenzimet nga imbalanca	0.00	0.00	0.00	0	0
B.30	Total	1,364,647.92	1,636,050.02	1,703,838.09	104.14	125

Rezultati financiar

Gjatë këtij tremujori ndërmarrja ka pasur rezultat negativ financiar në vlerë prej - 275,185€. Në vijim mund të shihet pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tabela 3. Pasqyra e të ardhurave TM3 2025

TM3 me krahasime	2024	2025
Pasqyra e të ardhurave	Vlerat në €	Vlerat në €

Të Ardhurat nga shitja energjisë elektrike	2,789,925.47	1,519,440.53
Të Ardhurat nga jobalanca pozitive	117,821.95	69,442.16
Të Ardhurat nga shitja e ujit me shumicë	769,535.73	903,004.09
Te ardhurat nga ujitja	-	-
Të Ardhurat Tjera	40,790.29	97,013.57
Total te Ardhurat Bruto	3,718,073.44	2,588,900.35
Pagat dhe mëditjet	801,727.85	1,177,133.44
Shpenzimet për udhëtime zyrtare	-	1,608.39
Reprezentacioni	1,911.94	1,642.37
Shpenzimet e Marketingut	-	-
Shpenzimet e Mirëmbajtës	6,398.70	13,317.94
Shpenzimet Komunale	122,107.57	249,734.22
Material Harxhues	17,735.92	10,213.60
Material për rrjetin e ujitjes	22,926.86	22,193.94
Shpenzime për shërbime	410.00	20,806.85
Shpenzime Tjera	91,163.94	23,558.32
Shpenzimet Telekomunikuese	5,998.35	6,406.95
Derivatet	12,467.52	15,292.33
Kompensimi dhe Taksat	166,847.84	156,773.74
Kompensimi i Dëmeve	3,900.00	5,156.00
Shpenzimet nga Imbalanca	-	-
Totali i Shpenzimeve	1,253,596.49	1,703,838.09
Fitimi Operativ	2,464,476.95	885,062.26
Total Zhvlerësimi	1,149,465.49	1,160,247.62
Total Fitimi (Humbja) Neto	1,315,011.46	- 275,185.36

Zyra e Prokurimit

Gjatë tremujorit të tretë 2025 (TM3 2025), Departamenti i Prokurimit ka zhvilluar këto aktivitete:

#	Nr prok	Titulli	Data e inicimit	Procedura dhe vlera e parashiku ar	Data e hapjes	Nënshkri mkontrat e	Vlera e kontrat ës	Kompani a fituese	Komente
1	25_03 4	Furnizim me paisje gjeodezike dhe paisje përcjellse	16.04.202 5	E hapur Vlerë e Mesme 60,000.00 €	23.05.202 5	07.07..20 25	54,162. 00 €	OE "DWH- KOSOV A SH.P.K.	Kontraktuar!
2	25_04 3	Rehabilitimi i objektit-puntorisë se Autoparkut, çatia, depoja, objekti i rojes, rregullimi i zyrës së punetorëve, ndarja e terminalit, si dhe rregullimi i zyreve të Arkivës	15.05.202 5	E hapur Vlerë e Mesme 150,000.00 €	09.06.202 5	02.07.202 5	150,054 .73 €	GOE "IBM SH.P.K." : "BABAJ COMPA NY SH.P.K."	Kontraktuar!
3	25_05 0	OFRIMI I SHËRBIMIT JURIDIK PËR PËRFAQËSIM NË GJYKATË KOMERCIALE DHE INSTANCAT TJERA MË TË LARTA	16.05.202 5	E hapur Vlerë e Mesme 100,000.00 €	16.06.202 5	10.07.202 5	87,583. 14 €	OE "SEJDI U & QERKI NI" SH.P.K.	Kontraktuar!
4	25- 051	Furnizim me licenca për Microsoft Office 365 për nevojat e N.H. "Iber- Lepenci" sh.a	20..05.20 25	E hapur Vlerë e Mesme 48,900.00 €	11.06.202 5	04.07.202 5	34,087. 84 €	OE "Cactus " Sh.a	Kontraktuar!
5	25_03 8	Renovimi i Objektit te Drejtorise- RITENDER	21.05.202 5	E hapur Vlerë e Madhe 670,000.00 €	07.07.202 5	30.07.202 5	649,952 .77 €	GOE "BABAJ COMPA NY SH.P.K." : "IBM SH.P.K."	Kontraktuar!
6	25_03 7	Sanimi i gypit të dëmtuar të çelikut ne shtratin e lumit Iber - Ritender	13.06.202 5	E hapur Vlerë e Mesme 12,000.00 €	07.07.202 5				Anuluar, pas pranimit të një ofertë të papergjegjshme!
7	25_01 4	Furnizim me fazoneri - RITENDER 2	26.06.202 5	E hapur Vlerë e Madhe 150,000.00 €	13.08.202 5				Anuluar, asnjë ofertë e pranuar!
8	25_06 3	Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran	17.07.202 5	Vlerë Minimale 500.00 €	18.07.202 5				Anuluar, asnjë ofertë e pranuar!
9	25_06 5	Servisim i veturave	23.07.202 5	Vlerë Minimale 336.00 €	24.07.202 5	28.07.202 5	400.02	OE "Ramad an Raçi" B.I.	Kontraktuar!

10	25_06 7	Furnizimi me kutia për dhënien e ndihmës së parë, të vendosura në mure	24.07.2025	Vlerë Minimale 600.00 €	25.07.2025	/	/	/	Anuluar, oferta e vetme e pranuar e ka tejkaluar çmimin e parashikuar!
11	25_06 3	Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran - Retender	28.07.2025	Vlerë Minimale 500.00 €	29.07.2025	/	/	/	Anuluar, asnjë ofertë e pranuar!
12	24_05 4	Digjitalizimi, vektorizimi, gjeoreferencimi i projekteve të profilit gjatësor të kanalit, hartave të ujitjes dhe largpërçuesve	31.10.2024	E hapur Vlerë e mesme 50,000.00 €	25.11.2024	/	/	/	Sipas Vendimit të Panelit të OSHP: 2025/0308, aktiviteti është anuluar.
13	25_01 6	Rindërtimi segmenteve të pjesëve të Kanalit Besi-Graçankë	20.02.2025	E hapur Vlerë e Mesme 450,000.00 €	24.03.2025	/	/	/	Sipas Vendimit të Panelit të OSHP: 2025/0337, aktiviteti është anuluar.
14	25_02 7	Furnizim me Vetura me rimorkio për terren (6 copë)- RITENDER	17.03.2025	E hapur Vlerë e Madhe 360,000.00 €	05.05.2025	/	/	/	Sipas Vendimit të Panelit të OSHP: 2025/0523, aktiviteti është anuluar.
15	25_05 3	Furnizim me Kamioneta	02.06.2025	E hapur Vlerë e Madhe 300,000.00 €	22.07.2025	15.08.2025	279,188.00 €	OE "Profitec h" SH.P.K.	Kontraktuar!
16	25_05 2	Furnizimi dhe montimi i pjesëve për Nisan Qashqai dhe Reno Clio. - RITENDER	16.06.2025	E hapur Vlerë e Vogël 2,190.00	24.06.2025	09.07.2025	2,189.99 €	OE "Auto Mita" SH.P.K	Kontraktuar!
17	25_05 7	Furnizimi me pjesë rezervë për mirëmbajtjen e automjeteve dhe makinerive.	19.06.2025	E hapur Vlerë e Mesme 18,909.00 €	16.07.2025	07.08.2025	18,334.38 €	OE "Ramadan Raci" B.I.	Kontraktuar!
18	25_05 8	Furnizim dhe servisimin e aparateve për mbrojtje kundër zjarrit	19.06.2025	E hapur Vlerë e Mesme 12,000.00 €	16.07.2025	14.08.2025	10,893.76 €	OE NPSH "Emergj enca"	Kontraktuar!
19	25_06 1	Furnizim me pajisje të TI për Ndërmarrje	24.06.2025	E hapur Vlerë e Mesme 54,200.00 €	18.07.2025	/	/	/	Pas përfundimit të Vlerësimit, OE i pakënaqur ka bërë ankimim në OSHP.
20	25_06 2	Furnizimi me pompa të ujit për nevoja operative	26.06.2025	E hapur Vlerë e Mesme 6,000.00 €	08.07.2025	22.08.2025	3,246.18 €	OE "INFINITT" SH.P.K.	Kontraktuar!
21	25_03 7	Sanimi i gypit të dëmtuar të çelikut në shtratin e lumit Ibër - Ritender 2	18.07.2025	E hapur Vlerë e Mesme	11.08.2025	/	/	/	Anuluar, asnjë ofertë e pranuar!

				12,000.00 €					
22	25_06 6	Aneks - Riparimi i pompave të Drenazhes në SP Besi dhe SP Bivolak, Rehabilitimi i pompave në SP Samadregjë.	21.07.202 5	E hapur Vlerë e Vogël 1,098.58 €	24.07.202 5	05.08.202 5	1,097.4 0 €	OE "AL Group" SH.P.K.	Kontraktuar!
23	25_04 4	Furnizim me mjete mbrojtëse në punë - RITENDER	21.07.202 5	E hapur Vlerë e Mesme 25,500.00 €	15.08.202 5	/	/	/	Anuluar, pranuar vetëm një ofertë të papërgjegjshme për shpërblim me kontratë!
24	25_06 3	Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran - Ritender	28.07.202 5	500.00 €	29.07.202 5				Anuluar, asnjë ofertë e pranuar!
25	25_06 8	Zhvendosja Rivendosja e inventarit punues në faza të drejtorisë së Ibër-Lepencit	05.08.202 5	9,950.00 €	11.08.202 5	/	/	/	Anuluar, me datë 15.08.2025 Operatori Ekonomik fitues ka dërguar një e- mail, ku për shkak të ndryshimit të lokacionit të zhvendosjes, ka kërkuar që të bëhet anulimi i procedurës!
26	25_06 4	Digjitalizim, vektORIZIMI dhe krijimi i Sistemit Elektronik i menaxhimit të Arkivës dhe WEBGIS	06.08.202 5	500,000.00 €					Anuluar për shkak të moskoordinimit të specifikacioneve teknike me nevojat reale të ndërmarrjes, ku nuk janë përfshirë të gjitha kërkesat e nevojshme për realizimin e projektit. Këto kërkesa nuk mund të rregullohen në këtë fazë për arsye se nuk mund të përcaktohet efekti financiar i tyre!
27	25_06 3	Hartimi i Elaboratit Gjeodezik për Shpronësimin e Parcelës në Komoran-Ritender 2	06.08.202 5	500.00 €	07.08.202 5	12.08.202 5	424.80 €	OE "GJEO- PROJE KT" SH.P.K.	Kontraktuar!

28	25_06_9	Furnizim me Kondenzator për SP Fushticë	07.08.2025	900.00 €	08.08.2025	13.08.2025	884.00 €	OE "Elektro SP" SH.P.K.	Kontraktuar!
29	25_06_8	Zhvendosja Rivendosja e inventarit punues në faza të drejtorisë së, Ibër-Lepencit"	18.08.2025	9,950.00 €	25.08.2025	25.08.2025	9,944.00 €	OE "BABAJ COMPANY" SH.P.K.	Kontraktuar!
30	25_07_0	Furnizimi dhe montimi i dy baterive për vetura dhe një bateri për gjenerator.	18.08.2025	477.00 €	19.08.2025	20.08.2025	450.99 €	OE "Auto-Albani" SH.P.K.	Kontraktuar!
31	25_07_2	Shërbime të skanimit për IL-në.	20.08.2025	990.00 €	22.08.2025	/	/	/	Anulluar, asnjë ofertë e pranuar!
32	25_07_2	Shërbime të skanimit për IL'në - RITENDER	27.08.2025	990.00 €	29.08.2025	/	/	/	Anulluar, asnjë ofertë e pranuar!
33	AQP	Furnizim me derivate për institucionet qëndrore të RKS	Procedure e udhehequr nga AQP	71,080.00	Procedur e e udhehequr nga AQP	11.06.2025	Sipas planifikimit!	OE "Petrol Company"	Kontraktuar nga AQP
34	25_00_2	Angazhimi i një zyreje projektuese për studimin e sanimit të rrëshqitjeve - RITENDER	12.05.2025	40,000.00 €	09.06.2025	/	/	/	Pas pranimit të Vendimit të Panelit të OSHP. Aktiviteti është në Rivleresim, jemi në fazën e dhënjes së kontratës.
35	25_06_1	Furnizim me pajisje të TI për Ndërmarrje	24.06.2025	54,200.00 €	18.07.2025	/	/	/	Pas përfundimit të Vlerësimit, OE i pakënaqur ka bërë ankimim në OSHP.
36	25_03_6	Furnizim me pajisje UAV për matje gjeodezike dhe pjeset tjera përcjellse – RITENDER 1	06.08.2025	90,000.00 €	27.08.2025	/	/	/	Në proces!
37	25_07_3	Furnizim me kuti magazinimi për bartje, ruajtje dhe transport	21.08.2025	3,000.00 €	27.08.2025	04.09.2025	2,222.53 €	OE "SMART OFFICE & PRINT" SH.P.K.	Kontraktuar!
38	25_07_4	Dizajnimi, prodhimi dhe montimi i 4 shtyllave metalike në HC UJMAN.	04.09.2025	4,990.00 €	10.09.2025	29.09.2025	4,222.87 €	OE "BMS SOLUTIONS"	Kontraktuar!
39	25_03_7	Sanimi i gypit të dëmtuar të çelikut në shtratin e lumit Ibër - Ritender 3	08.09.2025	22,000.00 €	29.09.2025	/	/	/	Në proces!
40	25_07_1	Remonti i pajisjeve hidroturbinë të agregatëve A dhe B në HC	08.09.2025	100,000.00 €	30.09.2025	/	/	/	Në proces!

41	25_07 5	Mirëmbajtja e permanente e LP 10kV dhe LP 35kV	19.09.202 5	7,000.00 €	30.09.202 5	/	/	/	Anulluar, asnjë ofertë e pranuar!
----	------------	--	----------------	------------	----------------	---	---	---	--------------------------------------

Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim

Gjatë këtyre muajve **korrik-gusht-shtator pra TM3**, 2025 janë realizuar këto aktivitete:

Gjatë këtij tremujori ka vazhduar aktiviteti punës nga muajt paraprak dhe ka pasur zhvillime të tjera të cilat janë në kompetencën e drejtorisë.

- Projekti: **“Renovimi i Stacioneve Pompikë”**: Fushticë, Gjurashin, Korroticë, Krashticë (Gllobar), Pantinë, Samadrexhë dhe rregullimi i banjës dhe kuzhinës në Vushtri”. Projekti është përcjellë për kontrollim dhe përmirësim nga departamenti Ujitja. Pas vizitave njoftuese në objektet me stafin inxhinierik të shërbimeve të DPZH-së, ka vazhduar puna në terren për matje dhe evidentim të gjendjes ekzistuese të objekteve përkatëse. Janë realizuar matjet fillestare në të gjitha objektet e planifikuara, dhe ka filluar puna fillimisht në përgatitjen e vizatimeve teknike, të paramasës dhe parallogarisë për objektet në fjalë. Gjithashtu janë siguruar nga arkiva projektet ekzistuese të objekteve dhe janë skanuar planimetritë për të ndihmuar në saktësinë e vizatimeve teknike. Është kompletuar për dorëzim final Projekti ideor i renovimit me të gjitha fazat, për SP Fushticë, SP Gjurashin, SP Korroticë, SP Krashticë, SP. Samadrexhë, SP Pantinë dhe Nj.P. Vushtri.
- **Komision mbikëqyrës** – sipas vendimit 02-2533 dt.03.07.2025, është caktuar komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: **“Rehabilitimi i objekteve të punëtorisë së Autoparkut, çatia, depoja, objektet e rojes, rregullimi i zyres së punëtorëve, ndarja e terminalit, si dhe rregullimi zyreve të Arkives”**, me nr. identifikues IL-25-3986-5-2-1, dhe nr. Protokoli 02-2526 i dates 02.07.2025. Pas nënshkrimit të planit për menaxhim të kontratës, komisioni mbikëqyrës ka zhvilluar takime me Operatorin Ekonomik, dhe është bërë hapja e ditarit ndërtimor me datë 10.07.2025. Në bazë të inspektimeve në terren, punimet kanë filluar sipas kontratës dhe planit dinamik. Komisioni mbikëqyrës ka aprovuar punët sipas situacionit të I-rë, raporti i pjesshëm i punës, 08-3054 dt.30.07.2025. Pas inspektimeve në terren, komisioni ka kërkuar përmirësimin e disa defekteve dhe finalizimin e punëve sipas kontratës. Kontrata është në zhvillim, afër finalizimit.
- **Komision mbikëqyrës** - sipas vendimit 02-3067 dt.31.07.2025, është caktuar komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: **“Renovimi i objektit të Drejtorisë – RITENDER”**, me nr. të prokurimit IL-25-4484-5-1-1, Nr. Protokoli 02-3050 i datës 30.07.2025. Është nënshkruar PMK nga menaxheri i projektit dhe OE. Më dt. 04.09.2025 menaxheri i projektit ka dërguar Letrën për fillimin e punëve, me çrast OE ka filluar punët nga dt. 05.09.2025. Gjatë muajit shtator janë inspektuar zhvillimet e punimeve sipas planit dinamik. Janë mbajtur takime me komisionit, përfaqësuesve të Termokos-it dhe OE në lidhje me shkëputjen e përkohshme të rrjetit ekzistues të ngrohjes. Kontrata është në zhvillim.
- Projekti: **“Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për prodhim të energjisë alternative-Solare”**. Më dt.25.09.2025 komisioni mbikëqyrës dhe OE – Energy Services kanë mbajtur takim të nivelit teknik me përfaqësues të KEDS-it, në zyret qendrore të KEDS, për të

identifikuar pikat e mundshme të kyçjes në rrjet të KEDS-it për projektin e fizibilitetit. Kontrata është në zhvillim.

- Projekti: **"Hartimi i projektit kryesor Qendra protokolare në Ujman"** - janë hartuar Specifikat teknike dhe Detyra Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për Qendrën Protokolare në Ujman.
- **Komisioni për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit, i cili është jashtë afateve ligjore, për ruajtje të mëtutjeshme** - kanë vazhduar angazhimet e komisionit dhe stafit të DPZH-së të caktuar me vendim për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit në kuadër të departamentit. Sipas raportit të stafit të dt.13.05.2025, është klasifikuar 100% e dokumentacionit. Është mbajtur takim dypalësh në mes të Arkivës së shtetit dhe IL-së, me datë 04.09.2025 në zyret qendrore në Arkiven e Shtetit. Nga data 09.09.2025 deri me datën 15.09.2025, është punuar në listen për shenjat unike për klasifikim të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre, për klasifikim të dokumenteve për ndërmarrjen e Ibër-Lepenc-it.
- **Komision vlerësues** – sipas vendimit është caktuar komisioni vlerësues për tenderin: **"Zhvendosja Rivendosja e inventarit punues në faza të drejtorisë së Ibër-Lepencit"**, me nr. Identifikues: IL-25-7136-2-2-1 (I brendshëm IL-25-068-2-3-6) dhe nr. Protokoli: 02-3214 të datës 12.08.2025. Punët e vlerësimit janë zhvilluar më dt. 12.08.2025
- **Komision Ri- vlerësimi** - për tenderin: **"Furnizimi me pompa të ujit për nevoja operative"**. IL—25-4023-2-2-1, I brendshëm IL-25-5765-1-3-6. Me vendim të KE-së, nr.02-2740, dt.10.07.2025, është caktuar komisioni dhe më dt.14.08.2025, janë zhvilluar punët për Ri-vlerësimin e tenderit në fjalë, pas ankesave të OE.
- **Zhvendosja në objektin e ri** – Nga dt. 21.08.2025 stafi i DPZH-se është angazhuar në seleksionimin e materialit ekzistues dhe paketimin për bartje nga objekti i drejtorisë i cili do të renovohet, për në objektin e ri ku vendoset stafi i IL-së, si dhe një pjesë të materialit për në Shkabaj.
- **Komision për pranim të paisjeve gjeodezike** – me datë 18/08/2025 është bërë pranimi i paisjeve gjeodezike nga komisioni. Kontrata "Furnizimi me Paisje Gjeodezike dhe Paisje Përcjellëse" me nr të prokurimit IL-25-3180-1-2-1/B08-0014626.
- **Komision mbikëqyrës** – në bazë të vendimit 02-3067 dt.31.07.2025, është caktuar komisioni mbikëqyrës për menaxhimin e kontratës: **"Renovimi i objektit të Drejtorisë – RITENDER"**, me nr. të prokurimit IL-25-4484-5-1-1, Nr. Protokoli 02-3050 i dates 30.07.2025.
- **Hartimi i specifikave për projektin: "Zhvendosje të Punëtorëve të Drejtorisë gjatë renovimit gjeneral të zyreve aktuale, për periudhë gjashtë mujore dhe shpenzimet shtesë"**, është bërë evidentimi i inventarit dhe materialit zyrtar për zhvendosje, dhe punimi i draftit përfundimtar të specifikave teknike, është dërguar me dt. 30.07.2025, për vazhdim të procedurave të prokurimit.
- **Komision vlerësues** – Rivlerësim i tenderit: **Angazhimi i një zyreje projektuese për studimin e sanimit të rrëshqitjeve** me nr. Identifikues: IL-25-4023-2-2-1 (I brendshëm IL-25-002-2-2-1) dhe nr. Protokoli: 02-1932 të datës 12-06-2025. Më dt. 07.07.2025, 14.07.2025 dhe me datën 16.07.2025, janë zhvilluar punët për Ri- vlerësimin e tenderit në fjalë, pas ankesave të OE.
- **Komision vlerësues** – Vlerësim i tenderit: **Furnizimi me paisje UAC për matje gjeodezike dhe pjesët tjera përcjellese-RITENDER** me nr. Identifikues: IL-25-5407-1-2-1 (I brendshëm IL-25-036-121) dhe nr. Protokoli: 02-2858 të datës 16-07-2025.
- **Komision vlerësimi / Rivlerësimi** - për tenderin: **"Furnizimi me pompa të ujit për nevoja operative"**. IL-25-4023-2-2-1, i brendshëm IL-25-5765-1-3-6. Vendimi i KE-së, nr.02-2740, dt.10.07.2025. Më dt.10.07.2025, janë zhvilluar punët për vlerësimin e tenderit në fjalë. Më

dt.17.07.2025, dhe dt. 31.07.2025 janë zhvilluar punët për Ri-vlerësimin e tenderit në fjalë pas ankesave të OE.

- **Komision vlerësues** – Vlerësim i tenderit: **"Renovim i Objektit të Drejtorisë – Ritender"** me nr. Identifikues: IL-25-4484-1-2-1 (i brendshëm IL-25-038-121) dhe nr. Protokoli: 02-2860 të datës 16-07-2025.
- **Skanime të projekteve të arkivës**– Me datë 03/07/2025 kanë pranuar skanerin ekzistues në Shkabaj, është testur dhe është vënë në funksion. Pas aprovimit të kërkesës për qasje në arkivë nga Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta së bashku me zyrtarë e arkivës, janë hulumtuar, siguruar projektet dhe bërë skanim: SP.Fushticë, SP. Gjurashin, SP. Korrotice, SP.Krashtice, SP.Pantinë. Skanimet e bëra përfshijnë vetëm planimetritë e projekteve.
 - Pjesëmarrja në komisione të ndryshme nga punëtorët e DPZH-së sipas vendimit.
 - Pjesëmarrja në trajnime të stafit të DPZH-së sipas profilit profesional.
 - Punë rreth planifikimit për Planin e Biznesit 2026.
 - Hartimi i specifikave teknike të projekteve të mbetura sipas Planit të Prokurimit dhe sipas Planit të Biznesit 2025 në kuadër të DPZH-së.

Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta

Përveç punëve të zakonshme me të cilat përballët shërbimi, gjatë periudhës tremujore korrik-gusht-shtator , pra TM3 - 2025 është zhvilluar procedurë për lëndët si në vazhdim të tabelës :

Nr.	I paditur/debitor	Paditës/kreditor	Kontesti	Rrjedha
1	N.H "Ibër-Lepenc" Sh.A	Remzije Gashi	Kompenzim	Gjatë kësaj periudhe, nga Gjykata Themelore në Prishtinë është pranuar aktgjykimi me numër C.nr.1116/2021, i cili është në favor të ndërmarrjes.
2	Branislav Nidiq NH "Ibër Lepenc"Sh.A Ndermarrja Publike Banesore	Hamdi Zenelaj	Vërtetim i të Drejtës së Pronës	Me datë 01.07.2025, kemi pranuar revizionin me numër 2492, të datës 01.07.2025, të ushtruar nga Avokati Xhafer Maloku, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në lëndën me numër A.C. nr. 6433/2022, të datës 29.04.2025.

3	N.H "Ibër Lepenc" Sh.A	Emin Zejnullahu	Kontest pronsor	Me datë 14.07.2025, kemi pranuar aktgjykimin me numër 05-2785, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – dega në Vushtrri. Kundër këtij aktgjykimi, më datë 17.07.2025 kemi dorëzuar ankesë brenda afatit ligjor, duke kërkuar shqyrtimin e vendimit në instancën e dytë. Kundër të njejtit aktgjykim me datë 26.09.2025, kemi pranuar ankesën e ushtruar nga av. Kada Bunjaku Percuku.
4	Afrim Sadiku	N.H "Ibër- Lepenc" Sh.A	Lirim prone	Në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, më datë 10 korrik 2025, është mbajtur seanca gjyqësore, në të cilën ka munguar pala e paditur, pas pranimit të plotësimit të ekspertizës nw kwtw seance, kemi dorëzuar precizimin e padisë. Poashtu me datwn 02.09.2025 është mbajtur seanca gjyqësore, në të cilën perseri ka munguar pala e paditur. Ndersa me daten 23.09.2025, është mbajtur seanca përfundimtare, në të cilën kanë qenë të pranishëm pala e paditur dhe eksperti i gjeodezisë. Aktualisht, jemi në pritje të aktgjykimit.
5	NH "Ibër Lepenc" Sh.A	Hamit Osmani	Kontest Prone	Më datë 17.09.2025, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kemi dorëzuar ankesë kundër aktgjykimit C.nr.2612/2023, të datës 18.07.2025.

Përveç aktiviteteve të sipërcekura, Zyra Ligjore gjatë periudhës raportuese TM3 – 2025 ka realizuar edhe këto aktivitete:

Gjatë periudhës raportuese, Zyra Ligjore ka vazhduar të ushtrojë funksionet e saj në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore, pavarësisht vështirësive të paraqitura gjatë kësaj kohe. Për shkak të temperaturave të larta dhe kushteve klimatike, gjykatat kanë punuar me kapacitet të reduktuar, çka ka ndikuar në shtyrjen e seancave gjyqësore. Si rrjedhojë, gjatë kësaj periudhe nuk janë zhvilluar seanca gjyqësore dhe ka pasur ndërprerje të përkohshme në trajtimin aktiv të lëndëve në procedurë. Më datë 01 gusht 2025, është përgatitur dhe dorëzuar kallëzim penal ndaj ish punëtorit të ndërmarrjes në lidhje me veprimtarit që dyshohet se përbëjnë vepra penale, të cilat janë të ndëshkueshme sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Dokumentacioni përkatës është kompletuar dhe është përfshirë në dosjen e kallëzimit, e cila është dorëzuar zyrtarisht në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Gjatë kësaj periudhe Zyra Ligjore ka bërë përgatitjet e nevojshme për menaxhimin e kontratave për angazhimin e shoqërisë së avokatisë, e cila do të ofrojë përfaqësim ligjor në dy raste gjyqësore që ndërlidhen me tri lëndë, të cilat burojnë nga marrëdhënie kontraktuale ndërkombëtare dhe konteste tregtare. Menaxhimi përfshin përgatitjen për zbatimin e përfaqësimit në raste që lidhen me kontratat FIDIC dhe EFET, në përputhje me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar. Një ndër angazhimet kryesore ka qenë procesi i paketimit, sistemit dhe bartjes së të gjitha lëndëve dhe dokumentacionit juridik nga objekti i vjetër në ambientet e reja të ndërmarrjes. Dokumentacioni i shpronësimit që ka qenë në një depo në katin e dytë është bartur dhe sistemuar në teresin në arkive të ndërmarrjes, zyra ligjore ka kontribuar edhe në sistemimin dhe bartjen e dokumentacionit të vjetër gjeodezik të cilat janë sistemuar gjithashtu në arkive të ndërmarrjes në bashkpunim me shefin e gjeodezisë. Ndryshimi i ambientit të punës ka paraqitur ngarkesë shtesë në aspektin logjistik dhe organizativ, mirëpo i gjithë procesi është përmbyllur me sukses.

Njësia zbatuese e projektit WSCP

Aktivitetet në kuadër Projektit të Bankës Botërore të zhvilluara gjatë tremujorit të tretë (TM3) janë pasqyruar si në vazhdim :

	NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A. HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C. VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.
Projekti me Bankën Botërore	
RAPORTI TREMUJOR (TM3_2025)	

Emri i Kontratës:	Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit - WSCP
Investitori	N.H. "Ibër Lepenc" Sh.A Prishtinë
Nën-projektet	1.Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit 2.Konsulenca 3.SCADA
1. Emri i Projektit	Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit
Kontraktori	"Famis.CO and Kit AK Gradnje"
Data e firmosjes së kontratës	24/05/2023
Çmimi i Kontratës:	12,875,191.63 €
2. Emri i Projektit	Konsulenca – Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor
Kontraktori	"IPE Proing sh.p.k"
Data e firmosjes së kontratës	08/06/2019
Çmimi i Kontratës:	270,700.00 €
3. Emri i Projektit	Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA
Kontraktori:	JV Interadira & OSKAR-EL
Data e firmosjes së kontratës	21/05/2019
Çmimi i Kontratës:	1,072,044.24 €
Vlera e punimeve të kryera:	899,923.20 €
Periudha Raportuese: 01.07.2025 - 30.09.2025	

Gjatë periudhës Korrik – Shtator, kontraktori nuk ka zhvilluar aktivitete ndërtimore në zonën e punimeve për shkak të nevojës për të siguruar qarkullimin e pandërprerë të ujit në kanalin e Ibër-Lepencit. Kjo periudhë përkon me sezonin e ujitjes, dhe ndërhyrjet në kanal do të rrezikojnë furnizimin me ujë për bujqësinë dhe përdoruesit e tjerë përgjatë sistemit.

Njeherit, kjo ishte edhe kërkesa zyrtare nga KE i Iber Lepencit.

Bazuar në këto rrethana teknike dhe operacionale, punimet janë pezulluar përkohësisht, ndërsa aktivitetet do të rifillojnë menjëherë sapo të përfundojë sezoni i ujitjes dhe të krijohen kushtet e nevojshme për ndërhyrje të sigurt dhe pa ndërprerje të shërbimit.

Aktivitetet e punës dhe raportimi i tyre

Punimet e rehabilitimit dhe riparimit përfshijnë si më poshtë:

1. Rindërtimi i pjesëve të hapura të të kanalit trapezoid dhe drejtkëndësh me Beton (gjatësia totale përafërsisht 9,194.70 m në gjithsej 55 seksione, në komunat: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtri, dhe Obiliq), duke ruajtur rrjedhën e pandërprerë të Ujit.

2. Zëvendësimi i kanalit të hapur pranë fshatit Zubin Potok me elemente nga betoni dhe mbulesë të kanalit (gjatësia përafërsisht 400 m).

3. Ndërtimi i sektorit të dytë 2 të Rezervuarit Bufer me gjatësi 800 m dhe gjerësi 8m'.

4. Riparimi i Akuadukteve me gjatësi 24600.23m², riparimi li sipërfaqes së brendshme të akuadukteve duke riparuar vrimat dhe aplikimin e materialit hidroizolues si shtresë e sipërme duke përfshirë trajtimin e fugave sipas Specifikimit Teknik dhe kërkesave të furnizuesit.

Numri i akuadukteve është 17 copë me gjatësi totale përafërsisht. 1,989,264.01m në komunat Zubin Potok 7, Mitrovicë 2 dhe Vushtri 8.

5. Punime të tjera

Ndërtimi i murit mbrojtës 318 m'. Pastrimi dhe rivendosja e 41 lëshesave ekzistuese dhe ndërtimi i 10 kanaleve të reja.

Ndërtimi i 21 kutive të shpërndarjes së ujit (dhoma betoni nëntokësore direkt në buzë të kanalit me marrjen e ujit nga kanali)

Instalimi i 13 rrjetave metalike në kalimine kanalit nga seksionet e kanalit të hapur në atë nëntokësor.

Punimi i gropave septike (pellgje betoni nëntokësor, 4 x 8,000L), për lidhje me shtëpitë afër kanalit.

6. Çështjet mjedisore

Ekzekutimi i punimeve të riparimit dhe rehabilitimit duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESI AF), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF), Kornizën e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), politikat dhe procedurat e Bankës Botërore, si dhe legjislacioni.

- Kontraktori "JV Famis Co dhe Kit AK Gradnje"

Vazhdimi i punimeve në kanalën kryesor

Pas nënshkrimit të kontratës me datën 24.05.2023, kontraktori "Famis Co dhe Kit AK Gradnje" kanë paraqitur Planin Dinamik të mobilizimit në teren dhe kanë filluar punët sipas kushteve të kontratës FIDIC, ku bazohet projekti "Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit".

Gjatë kësaj periudhe të raportimit kontraktori ka punuar me disa pozicione të punimeve:

Kanali Trapezoidal

Në segmentin A3.6 nga Km 27+138.37 deri në Km 27+591.20, me gjatësi $L = 452.83$ m, kontraktori ka përfunduar rreth 150 m, ose 33% të segmentit.

Në segmentin A4.2 nga Km 29+725.46 deri në Km 31+190.89, me gjatësi $L = 1,465.43$ m, kontraktori ka përfunduar rreth 1,000 m, ose 68% të segmentit.

Kontraktori ka përfunduar 4 segmente, ndërsa 2 segmente të tjera kanë përparuar si më poshtë: Deri më tani, Kontraktori ka bërë përparim në segmentet e mëposhtme:

Nr	Segment No.	from	Up to	Length	Progress
1	A2.1	Km 16+540.00	Km 16+864.27	$L = 324.27$ m	100.00%
2	A3.2	Km 22+340.00	Km 23+142.70	$L = 802.70$ m	0.00%
3	A3.6	Km 27+138.37	Km 27+591.20	$L = 452.83$ m	33.00% Bypass installed
4	A4.2	Km 29+725.46	Km 31+190.89	$L = 1,465.43$ m	68.00% 1,000m' finished
5	A6.1	Km 36+147.52	Km 36+517.89	$L = 370.37$ m	0.00%
6	A6.2	Km 36+631.37	Km 36+733	$L = 101.20$ m	100.00%
7	A7.2	Km 42+266.03	Km 42+527.60	$L = 261.57$ m	100.00%
8	A7.4	Km 45+704.08	Km 46+405.13	$L = 701.05$ m	100.00%
Total:				4,478.98 m	69.35% cost based 2,534.08 m' completed 64.56% length completed

Deri më tani, Kontraktori ka përfunduar 2,534.08 m nga gjithsej 4,478.98 m të kanalit trapezoidal, ose 64.56% të gjatësisë së tij.

Rehabilitimi i Akuadukteve

Kontraktori ka përfunduar rehabilitimin e 16 segmenteve të akuadukteve. Duke arritur një progres prej afërsisht 96.42% në rehabilitimin e tyre ose duke përfunduar 2,053.70 metra nga gjithsej 2,129.89 metra.

No	PAK	from	Up to	Length	Progress
1	PAK1.1	Km 04+305.01	Km 04+369.35	L=64.34 m'	100.00%
2	PAK1.2	Km 05+054.00	Km 05+126.55	L=72.55 m'	100.00%
3	PAK1.3	Km 07+529.57	Km 07+586.89	L=57.32 m'	100.00%
4	PAK1.4	Km 08+542.73	Km 08+620.00	L=77.27 m'	100.00%
5	PAK1.5	Km 09+170.86	Km 09+344.39	L=173.53 m'	100.00%
6	PAK1.6	Km 09+738.08	Km 09+817.92	L=79.84 m'	100.00%
7	PAK1.7	Km 11+078.87	Km 11+114.64	L=35.77 m'	0.00%
8	PAK1.8	Km 12+497.55	Km 12+497.55	L=162.45 m'	100.00%
9	PAK2.1	Km 19+632.40	Km 19+799.26	L=166.86 m'	100.00%
10	PAK2.2	Km 20+085.68	Km 20+417.58	L=331.90 m'	100.00%
11	PAK2.3	Km 23+894.68	Km 24+033.93	L=139.25 m'	100.00%
12	PAK2.4	Km 24+894.78	Km 25+080.39	L=185.61 m'	100.00%
13	PAK2.5	Km 26+111.90	Km 26+188.67	L=76.77 m'	100.00%
14	PAK2.6	Km 27+011.97	Km 27+138.37	L=126.40 m'	100.00%
15	PAK3.3	Km 34+934.73	Km 34+975.15	L=40.42 m'	0.00%
16	PAK3.5	Km 36+517.87	Km 36+631.37	L=113.50 m'	100.00%
17	PAK4.1	Km 42+635.09	Km 42+760.74	L=125.65 m'	100.00%
18	E2A.1	Km 45+603.62	Km 45+704.08	L=100.46 m'	100.00%
Total:				L=2,129.89 m'	96.42%

Kanalet

drejtkëndëshe

Kontraktori ka vazhduar me devijimin e rrjedhës së ujit përmes kanalit anësor, në Segmentin B10A.15 nga Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47, dhe ka vazhduar me segmente të tjera për kanalën e tipit drejtkëndësh.

Nr	Segment No.	from	Up to	Length	Progress
1	B10A.15	Km 47+280.00	Km 47+364.47	L=84.47m	100%
2	B10A.16	Km 47+551.50	Km 47+620.00	L=68.50m	100%
3	B10A.17	Km 47+738.54	Km 47+869.05	L=130.51m	100%
4	B10A.18	Km 48+113.12	Km 48+378.81	L=265.69m	100%
5	B10A.19	Km 48+428.80	Km 48+496.00	L=67.20m	100%
6	B10A.19'	Km 48+604.75	Km 48+684.59	L=79.84m	100%
7	B10A.20	Km 48+854.91	Km 49+191.00	L=336.09m	94%
Total:				1,032.30	96.74%

Deri më tani, Kontraktori ka përfunduar 998.69 metra nga gjithsej 1,032.30 metra, ose 96.74%.

Seksioni i kanalit drejtkëndësh i mbyllur – L = 405.38m

Ky segment ndodhet në qytetin e Zubin Potokut dhe, si i tillë, qasja në kantier është e kufizuar sidmos pas ngjarjeve me rastin e demtimit të Aquadtit në Varage, Veri. Progresi i punimeve në këtë segment është rreth 5% deri më tani.


Rehabilitimi i kanalit në përqindje (%)


Bill No. A2 - Canal Rehabilitation	length	segments	Progress		
	m'	pcs.	length	number	percentage
Canal section for trapezoidal canal type	4,479.42	8	2,534.08 m	4 (2 ongoing)	56.57%
Canal section for rectangular open type	1,032.30	7	998.69 m	6.90	96.74%
Canal section rectangular closed	405.38	1	0.00 m	0.00	0.00%
Rehabilitation of Aqueduct	2,129.89	18	2,053.70 m	16.00	96.42%

Puseta BA për SCADA

Kontraktori është në përfundim të ndërtimit të pusetës për sistemin Scada tek përfundimi i kanalit afër Kosova – B. Ka mbetur vetëm instalimi i Ujëmatsave dhe përfundimi i punëve të izolimit.

Ecuria e punimeve në krahasim me kontratën kumulative.





Më poshtë janë paraqitur disa foto të punimeve në teren:

